



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 179, Datë 13.07.2022

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBPETROL” SH.A. PËR RINOVIMIN E  
LICENCËS NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.07.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1118/3 prot., datë 12.07.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ALBPETROL” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 971 prot., datë 27.06.2022, ka paraqitur kërkesën për të rinovuar licencën në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Gjithashtu, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 971/1 prot., datë 04.07.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Shoqëria është mbajtëse e licencës nr. 382, seria F17, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 141, datë 06.09.2017, për një afat 5-vjeçar, deri më 06.09.2022.
- Në zbatim të nenit 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, i licencuari duhet të paraqesë në ERE një aplikim për rinovimin e licencës jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Aplikimi i shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike është paraqitur në afat.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Shoqëria “ALBPETROL” sh.a. nuk rezulton debitore ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik dhe administrativ; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”.
  - Dokumentacioni juridik dhe administrativ - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b” “c” dhe “e”.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat “a” dhe “d”.
  - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.8, gërma “a”, “b” dhe “f”.

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar ose plotësuar pjesërisht, si vijon:

#### **Dokumentacioni juridik dhe administrativ**

##### neni 9, pika 2:

- **gërma “d”** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë të Rrethit Fier, për vetë shoqërinë “ALBPETROL” sh.a.

#### **Dokumentacioni financiar dhe fiskal**

##### neni 9, pika 3:

- **gërma “b”** Shoqëria duhet të depozitojë pasqyrat financiare të vitit 2021, të cilat nuk janë përcjellë, si dhe të depozitojë në format origjinal ose fotokopje të njësuar pasqyrat financiare të viteve 2019 dhe 2020, të cilat janë depozituar vetëm në format elektronik.
- **gërma “c”** Shoqëria duhet të përcjellë në ERE dokumentacion në lidhje me mbështetjen financiare të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.

#### **Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike**

##### neni 9, pika 4.8

- **gërma “b”** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion/dokumentacion në lidhje me kapitalin financiar që do të vendosë në dispozicion të ushtrimit të veprimtarisë.
- **gërma “d”** Shoqëria duhet të depozitojë informacion të detajuar mbi përmbushjen e kontratave.
- **gërma “e”** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE sistemin IT për veprimtari të furnizimit.
- **gërma “g”** Shoqëria duhet të përcjellë dokumentacionin specifik që kërkon kjo pikë e rregullores në lidhje me disponimin e zyrave për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve.
- **gërma “h”** Shoqëria duhet të depozitojë të dhëna mbi kategoritë, nënkategoritë, nivelin e konsumatorëve dhe sasinë e energjisë në GWh për secilin nga 5 vitet e licencës.
- **gërma “i”** Shoqëria duhet të paraqesë informacion në lidhje me mënyrën e realizimit të sistemit të matjes.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., në veprimtari të furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**